Numër: 01/280
Datë: 25.06.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë nr. 09/2019, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.06.2021 nxjerrë këtë:

VENDIM

I. **Nuk akreditohet** Institucioni "International Beauty Brands", me adresë: Rr. Prishtinë – Fushë Kosovë, në Komunën e Fushë Kosovë, me kualifikimin: **Parukier,** Niveli IV sipas KKK, me 27 kredi të AAP.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Institucioni International Beauty Brands (tutje IBB), me adresë Rr. Prishtinë – Fushë Kosovë, në Komunën e Fushë Kosovës, ka parashtruar kërkesë pranë Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) për akreditim të Institucionit dhe validim të kualifikimit Parukier, Niveli IV, sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) me 27 kredi të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) të cekura si në dispozitivin e këtij vendimi.

Më datë 31.03.2021 me qëllim të vlerësimit të aplikacionit, institucioni "IBB" është vizituar nga ekipi i ekspertët vendor të akreditimit me këtë përbërje: 1. Edlira Hasula – eksperte, kryesuese paneli; 2. Vehbi Neziri – ekspert për sigurimin e cilësisë, anëtar paneli, dhe 3. Violeta Ruzi – eksperte, anëtare e panelit.

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) në mbledhjen e mbajtur me datë 25.06.2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Institucioni "IBB" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet

përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në pjesën e dytë të raportit vlerësues për akreditim të institucioneve për zbatimin e Njohjes të Mësimit Paraprak (NjMP), ku trajtohet "**Komentet për cilësinë e të dhënave të paraqitura dhe dokumenteve përkatëse**", ekspertët vlerësojnë se:

"Stafi që është në rolet e koordinatores, mentores dhe vlerësueses së brendshme kanë njohuri për ekzistencën e standardit të profesionit dhe njohin disa nga modulet, por megjithatë nuk kanë arritur të dëshmojnë se kanë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura për procesin e koordinimit, mentorimit dhe vlerësimit në procesin e NjMP-së.

Në dëshmitë e fundit të dërguar nga institucioni IBB, institucioni ka zëvendësuar znj. Afërdita Ibishi dhe znj. Jehona Plakiqi me znj. Adelina Begaj dhe znj. Jehona Azemi, por nuk tregohet se cila është në rolin e mentores e cila të vlerësueses. Dëshmitë e shkollimit dhe përvojës së tyre nuk tregojnë përvojë, njohuri, kompetenca për të zbatuar NjMP në rolin e tyre si mentore apo vlerësuese e brendshme".

Në pjesën e dytë të raportit të akreditimit ku trajtohet "**Qëndrimet për rekomandimet nga ekipi i ekspertëve**", ekspertët vlerësojnë se:

Duke u bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit, në politikat dhe procedurat e qendrës, dëshmive në mbështetje të tyre dhe në bazë të Kornizës së Kualifikimeve Kombëtare ekipi i ekspertëve rekomandon mos validimin e kualifikimit. Arsyetimi bazohet kapacitetet e stafit të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak, siç janë koordinatori, mentori dhe vlerësuesit e brendshëm. Një pjesë e stafit të përcaktuar në këto role ka përvojë në fushën e parukerisë, por nuk kanë përvojë në trajnime e vlerësime, prandaj ekipi në bazë edhe të bisedave, por edhe të dëshmive të paraqitura mendon se nuk kanë kapacitete për të zbatuar NjMP-në.

Gjatë procesit të vlerësimit, institucioni IBB ka bërë kërkesë në AKK për një afat shtesë, për të shtuar/zëvendësuar stafin. Në dëshmitë shtesë të dërguara me 7 qershor 2021 janë bërë ndryshime/plotësime të stafit me Jehona Azemin dhe Adelina Begaj. Në këtë rast ekipi i ekspertëve nuk e ka të qartë nëse stafi i ri ka zëvendësuar stafin e vjetër apo është staf shtesë.

Në bazë të kontratave, CV, diplomave për kryerjen e shkollës së mesme dhe kopjeve të certifikatave për znj. Adelina Begaj dhe znj. Jehona Azemin nuk dëshmohet se ato kanë përvojë në trajnimin apo në vlerësimin e kandidatëve. Si rrjedhojë ekipi mendon se znj. Begaj dhe znj. Azemi nuk e kanë përvojën e duhur dhe nuk kanë njohuri e as kompetenca për të zbatuar NjMP në rolin e mentores, koordinatores apo vlerësueses së NjMP-së.

Një pjesë e stafit të angazhuar në procesin e NjMP ka eksperiencë profesionale dhe është certifikuar për profesionin e parukerisë, por gjatë takimit nuk arritën të dëshmojnë dhe të përcjellin se e njohin dhe janë në gjendje ta drejtojnë dhe zhvillojnë procesin e NjMP. Më pas IBB bëri ndryshime në staf, por ato nuk ishin të trajnuara për NjMP. Duke pasur parasysh parimet e NJMP, obligimet e palëve të interesit, besueshmërinë, si dhe kredibilitetin e legjitimitetin e procesit, rekomandohet që profesionistët e NjMP (koordinatorja, mentorja dhe vlerësuesja e brendshme) të kenë njohuri për të kuptuar dhe zbatuar procesin e NjMP si një tërësi. Roli i koordinatorit, mentorit dhe vlerësuesve të brendshëm e të jashtëm janë role bazë dhe përcaktuese për procesin e NjMP-së, prandaj ky staf duhet të ketë njohuri dhe shkathtësitë e duhura për të zbatuar njohjen e mësimit paraprak.

Bazuar në këto rrethana, Këshilli Drejtues i AKK-së, lidhur me aplikacionin e institucionit IBB, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e AKK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucioni International Beauty Brands, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK